



SHTOJCA E DIPLOMES

Shtojca e diplomës është një dokument që lëshohet bashkë me diplomën e arsimit të lartë, e cila ofron një përshkrim të standardizuar të natyrës, nivelit, kontekstit, përmbajtjes dhe statusit të studimeve që ka përfunduar bartësi i asaj diplome. Shtojca e diplomës përgatitet nga institucionet e arsimit të lartë sipas standardeve të dakorduara nga Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës dhe UNESCO. Ajo, po ashtu është pjesë e [Europass framework transparency tools](#). Qëllimi i shtojcës është të ofrojë të dhëna të mjaftueshme dhe të pavarura për të përmirësuar ‘transparencën’ ndërkombëtare sa i përket njohjes së kualifikimeve profesionale dhe akademike (diplomave, gradave, certifikatave etj.). Ajo nuk duhet të gjykojë vlerën e kualifikimit apo të përmbajë ndonjë sugjerim në lidhje me njohjen.

Të diplomuarit nga të gjitha vendet që janë pjesë e procesit të Bolonjës ([Bologna Process](#)) kanë të drejtë të marrin automatikisht Shtojcën e Diplomës, pa pagesë dhe në një gjuhë që flitet në masë të madhe në Evropë.

Parimet themelore

Shtojca e Diplomës është dizajnuar si mjet për të ndihmuar (por që nuk garanton) njohjen – ajo nuk është CV apo zëvendësim i kualifikimit origjinal. Shtojca mbështetet në parime të rëndësishme bazike që respektojnë autonominë akademike kombëtare dhe ndërkombëtare si vijon.

Shtojca e diplomës është:

- instrument fleksibil, jo-përshkrues që ka mundësi t’i përshtatet nevojave lokale. Ajo mund të përdoret për të zëvendësuar ose avancuar qasjet aktuale.
- mjet që ka aplikim kombëtar dhe ndërkombëtar. Ajo është dizajnuar për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me njohjen e kualifikimeve në nivel ndërkombëtar por edhe vendor.
- një sistem që ndihmon njohjen për qëllime akademike dhe profesionale. Ajo ka potencial të jetë e vlefshëm për të gjitha institucionet e arsimit të lartë, organet profesionale, studentët, punëdhënësit, institucionet publike, qeveritë dhe qytetarët.
- qasje që në mënyrë specifike përjashton pretendimet dhe gjykimet e vlerave sa i përket barazisë duke ofruar informata të mjaftueshme dhe objektive që bëjnë të mundur për pranuesin e shtojcës të gjykojë vet kualifikimet në fjalë.
- instrument që duhet të përdoret me kujdes. Njohja e kualifikimeve të huaja duhet të shihet si proces i vlerësimit të kompetencave, përvojave dhe njohurive të fituara duke pas parasysh se duhet kërkuar ‘njohje fer’ e jo barasvlere të plotë (duke u fokusuar në rezultatet e të nxëniet dhe duke gjykuar në bazë të informatave kualitative dhe kuantitative që janë ofruar).
- set udhëzimesh që shmangë përfshirjen e detajeve të tepruara në mënyrë që të mos shkaktojë huti për përdoruesin.
- Pjesë shtesë e kredencialeve origjinale. Kredencialet duhet të mbesin të pandryshuara, dhe shtojca duhet të shoqërojë kredencialet autentike që dëshmojnë arritjen.

**Shtojca e diplomës përmban tetë seksione të informatave si vijon:**

1. bartësi i kualifikimit;
2. kualifikimi;
3. niveli i kualifikimit;
4. përmbajtjet dhe rezultatet e arritura;
5. funksioni i kualifikimit;
6. informata shtesë;
7. certifikimi i shtojcës;
8. detaje rreth sistemit kombëtar të arsimit të lartë (ofruar nga [National Academic Recognition Information Centres \(NARICs\)](#)).

Përfitimet për institucionet e arsimit të lartë:

- kualifikime më transparente;
- gjykime të bazuara në informata në lidhje me kualifikimet që mund të kuptohen edhe në kontekste tjera arsimore;
- kursim i kohës – duke ofruar përgjigje në shumë pyetje që shpesh iu parashtrohen institucioneve në lidhje me përmbajtjen dhe lëvizshmërinë e kualifikimeve;
- vazhdim i autonomisë kombëtare/institucionale brenda një kornize që është e pranueshme në gjithë Evropën;
- përmirësim i perspektives së të diplomuarve për punësim brenda dhe jashtë vendit;
- promovim më i madh i institucionit jashtë vendit.

Përfitimet për studentët:

- kualifikime që janë më lehtë të lexueshme dhe të krahasueshme jashtë vendit;
- përshkrim të saktë të karrierës akademike dhe të kompetencave të fituara gjatë studimeve;
- qasje më të lehtë në mundësitë për punë ose studime të mëtejme jashtë vendit.

Etiketa e Shtojcës së Diplomës

Etiketa e Shtojcës së Diplomës (ShD) është një lloj medalje nderi që i jepet institucioneve të arsimit të lartë që aplikojnë Shtojcën e Diplomës saktësisht në çdo aspekt.

Burime dhe informata tjera:

Informata të përgjithshme: http://ec.europa.eu/education/tools/diploma-supplement_en.htm or <http://www.europass.at/en/was-ist-europass/diploma-supplement/>

Përshkrimi i ShD: http://ec.europa.eu/education/policy/higher-education/doc/ds_en.pdf

Shembuj: <http://europass.cedefop.europa.eu/en/documents/european-skills-passport/diploma-supplement/examples>